



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KANCELARI

Nr. 6341/1 prot

Tiranë 19.12.2023

Lënda : Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak të kandidatëve për procedurën e konkurrimit
“ *Lëvizje paralele* ”

Në zbatim të nenit 57, të Ligjit 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, të neneve 9 dhe 17, të vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, udhëzimit nr. 85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil gjyqësor”, në përfundim të afatit kohor datë **18.12.2023** për dorëzimin e dokumentave personale për pozicionet e lira dhe nga verifikimi paraprak i dokumentacionit të kandidatit, për përmbushjen e kërkesave të përgjithshme dhe të veçanta të shpallura për konkurrim, sipas procedurës “ *Lëvizje paralele* ” Kancelari i Gjykatës së Lartë për pozicionin e shpallur në njoftimin e datës 04.12.2023 njofton se :

I. Procedura “Lëvizje paralele”

- Për **1(një)** vend vakant “*Drejtor - Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Financiare dhe Shërbimeve*” (*kategoria e mesme drejtuese II-2*),

do vijohet me procedurën e “*Ngritjes në detyrë*”, pasi në përfundim të afatit kohor të dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar në shpalljen përkatëse nuk është paraqitur asnjë kandidaturë sipas procedurës “*Lëvizje paralele*”.

Nëse rezulton që edhe sipas kësaj procedure nuk do të ketë kandidatë të kualifikuar atëherë do vijohet me plotësimin e kësaj vakance sipas procedurës “*Pranim në nivel drejtues*”.

Në përfundim të afatit kohor të dorëzimit të dokumentacionit për kandidatët që konkurrojnë sipas procedurës së “Ngritjes në detyrë ” (datë 26.12.2023) dhe “Pranim në nivel drejtues” (datë 03.01.2024) Kancelari i Gjykatës së Lartë, pas verifikimit paraprak të dokumentacionit, do të bëjë njoftimet përkatëse konform përcaktimeve ligjore.

KANCELAR NË DETYRË

ANILA KULO

